

Z. Bledar Doracaj ka përfunduar studimet e larta në vitin 2000 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në vijimësi ka kryer në Lecce, Itali studime Master në “Menaxhimin Publik dhe Ndërkombëtar”.

Përgjatë karrierës së tij mbi 20 vjeçare Z. Doracaj ka punuar në sektorin publik në pozicione drejtuese si, “Drejtor i Përgjithshëm” në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në *Ministrinë e Brendshme* (Mars 2015 – Dhjetor 2021), “Drejtor i Përgjithshëm” në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse po në *Ministrinë e Brendshme* (Janar 2014 – Mars 2015), Këshilltar Ligjor në Kabinetin e Zv/kryeministrit (Tetor 2004 – Shtator 2005). Eksperienca e z. Doracaj nuk kufizohet vetëm në sektorin publik, pasi ai ka punuar edhe në sektorin privat në pozicione si jurist, avokat apo drejtues. Gjithashtu, ka eksperiencë edhe në bashkëpunime ndërkombëtare siç është ai me *OSCE Presence in Albania* ku ka punuar si “Ekspert kombëtar për amendimin e ligjit për barazinë gjinore”.

Nga data 15 Shkurt 2022 e në vazhdim z. Doracaj kryen detyrën e “Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore” në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Gjithashtu, z. Doracaj ka eksperiencë edhe në mësimdhënie si Pedagog i Jashtëm në Akademinë e Rendit Publik "Arben Zylyftari" (2004 – 2005).

Gjatë karrierës së tij z. Doracaj ka kryer trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha si: Ngritja e fondeve, Hartimi i strategjive dhe Lidershipi, Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve, trajnime të avancuara për Menaxhimin Politik, Debatin politik në Evropën Juglindore etj.